




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-15343/23 datë: 22.06.2023



Npi – 01/257 datë: 23.06.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.06.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 23.06.2023 (e premtë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Praktikantet znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 26.05.2023,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (pas diskutimit publik)
3. Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për vitin 2023,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 26.05.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 26.05.2023.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Sa i përket KAB-it, Komuna e Shtimes e ka marrë seriozisht dhe ka organizuar debat publik nëpër fshatra dhe lagje urbane, po ashtu edhe me sportist, klube të biznesit etj. Në diskutim publik kanë marrë pjesë një numër i mirë i pjesëmarrësve edhe pse ne kërkojmë që ky numër të jetë edhe më i madhë në të ardhmen. Propozimet janë marrë dhe ato që kanë qenë të arsyeshme janë fut në dokument.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket dëgjimeve publike unë kamë marrë pjesë në shumë dëgjime në të cilat janë shterrë diskutimet me propozime dhe me kërkesa. Ka pas gjithpërfshirje por jo në nivelin e dëshiruar. Ka plot kërkesa që kanë hy në draftin e KAB-it 2024-2026. Ne duhet ti rekomandojmë Kuvendit miratimin e KAB-it 2024-2026.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Sa i përket KAB-it ne kemi thënë që të planifikohet buxheti për stafin ZKKK-së. Pastaj nuk përfshihet në buxhet çështja e mësimit në Qendrat mësimore e cila duhet të përfshihet në buxhet. Duhet të diksutohet edhe me Shoqërinë Civile.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, ne kemi vërejtë se ka disa rrugica në Shtime që janë ende pa u përfunduar. Ne kemi biseduar me drejtorin e urbanizmit z.Grejtalb Emini, e i cili na ka thënë që pritet së shpejti të përfundojnë.

z.Besnik Seferi; Rruga kah pusët e ujësjellësit është diskutuar. Janë diku 200-300 metra të pa asfaltuara.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, te rruga “Ardhmëria” kanë nevojë për një trafo.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe të ndahet buxheti për manifestimin e ditëve të Komuniteteve.

z.Besnik Seferi; Duhet të kemi çmimet e sakta për kërkesat.

z.Muhamet Mehmeti; Unë kam qenë organizator dhe mendoj që duhen 2000 euro.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë kisha shku me 500 euro për Komitetin Romë dhe për Komitetin Ashkali me 1000 euro.

z.Besnik Seferi; Nuk është që nuk pajtohem me propozimin tënd për 500 euro për Komitetin Romë dhe për Komitetin Ashkali 1000 euro.

z.Arton Demiri; Unë e di që Komiteti Ashkali janë më shumë, por për Komitetin Rom, mendoj se do të mjaftojnë 300 euro.

***Komiteti për Komunitete me 5 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe 0 “Abstenim” vendosi për ndarjen e gjithësej e 1500 euro. Për Komitetin Ashkali 1000 euro dhe për Komitetin Romë 500 euro për manifestimin e ditës së flamurit.**

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2024-2026, me propozimet si vijon:**

- 1. Të planifikohet pagesa e dy zyrtarëve në Zyrën për Komunitete dhe Kthim.**
- 2. Të ndahet Buxhet për Qendrat Mësimore për komunitetin pakicë.**
- 3. Vazhdimi i asfaltimit të pjesës së mbetur të rrugës “Hysiqi”, deri te Pusët e Ujësjellësit.**
- 4. Ndarje të linjës buxhetore në shumën prej 1500 euro për manifestimet e Komunitetit rom dhe ashkali. (1000 euro për Komitetin Ashkali dhe 500 për Komitetin Rom).**

Pika 3

Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për vitin 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se duhet me ju taku edhe kësaj kategorie të nënave lehona që janë shtetase të shteteve tjera por që janë të martuara në Kosovë. Unë jam pro që duhet me u përfshi sepse ne si VV-ë jemi propozues të kësaj nisme për nënat lehona.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; E qes në votim rekomandimin.

*** Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi t’i Rekomandoj Kuvendit, miratimin e Vendimit për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për vitin 2023, sipas propozimit të DSHMS-së.**

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Në ZKKK-ë u bënë 1 muaj që zyrtari ka dalë në pension, ne kemi biseduar me Kryetarin z.Qemajl Aliu, dhe na ka thënë se derisa të kryhet procedura e ankesave të brendshme ose të jashtme do ta bëjmë një zgjidhje. ZKKK-ja ka mbetur keqë.

z.Besnik Seferi; Është brengë çështja e zyrës duhet me ja hapë sytë Komunës. Duhet me pasë një arsye që mos me u marrë parasysh një rekomandim. Unë jam që të japim kohë për Ekzekutivin.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë e kam një kërkesë për Ekzekutivin që me na u përgjigjë pse nuk po merren parasysh rekomandimet tona. Nëse nuk zgjidhet çështja e ZKKK-së deri në fund të pushimeve unë do të japë dorëheqje nga Kryesuesi dhe anëtari i Komitetit për Komunitete.

***Komiteti për Komunitete unanimisht vendosi që të bëj kërkesë për Kryetarin, Kryesuesin dhe Drejtoritë Komunale të linjës që të përgjigjen në Rekomandimet e Komitetit për Komunitete.**

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:14h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

